



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:292925

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05651900

ARJ.nr.41/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani kryetar, Nebojša Boričić dhe Nenad Lazić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit, A.C., nga P., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës së Pensioneve, (MPMS-DAP), me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar për mes të autorizuarit sipas autorizimit, avokat Agron Curri nga Prishtina, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.366/2023, të datës 14.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30 Prill 2024, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi A.C., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.366/2023, të datës 14.02.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.366/2021, të datës 14.02.2024, në pikën I. të dispozitivit: Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, në P., Pika II. Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3030/19, i datës 09.03.2023. Pika III. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A.C., nga P., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, në P., me nr. të dosjestë datës 01.11.2019. Pika IV. Mbetet në fuqi vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, në P., me nr. të Dosjes të datës 01.11.2019, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e z/znj. A. C., me numër të ID, për Njohjen e të Drejtës në Kategorizim për Pension me Shkollim të Mesëm.

Paditësi për mes të autorizuarit të lartë cekur në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të cekur të Gjykatës së Apelit për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe për shkak të shkeljes të drejtës materiale, me propozim, të pranohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit e parashtruar nga paditësi A.C., të prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr. 366/2023, të datës 14. 02. 2024, dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3030/19, i datës 09.03.2023.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar të shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë, dhe pas shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton e paditura MPMS-DAP, Komisioni për ankesa dhe parashtrës, duke vendosur në rivendosje sipas rekomandimeve të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.8/17, të datës 07.08.2019, me vendimin e saj, me nr. të dosjes 203033 të datës 01.11.2019, e refuzon si të pa bazuar ankesën e paditësit A. C., për njohjen e të drejtës në kategorizim me shkollim të mesëm, me arsyetim se i njëjti nuk i plotëson kushtet sipas nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesëve të pensionit kontribut pagues, nga se kualifikimi shkollor nuk është në harmoni me kornizën ligjore.

Kundër këtij vendimi paditësi ushtron padi në konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin A.nr.3030/19 të datës 09.03.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit A.C., nga Komuna e P., II. ANULOHEN vendimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve -Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (DAPRK) në P., me dosje, i datës 01.11.2019, ndërsa paditësit i njihet e drejta në kategorinë e pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme. III. OBLIGOHET Ministria e e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Pensioneve (MPMS-DP) në P., që paditësit, ti njihet e drejta në kategorinë pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme, ashtu që në të ardhmen në baza mujore ti paguhet shuma adekuate për këtë lloj pensioni, si dhe ti kompensoj diferencën e pa paguar nga data e parashtrimit të kërkesës 05.05.2016 deri me datën 31.12.2018, diferencën e pagës sipas pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme në vlerë prej 14 euro në muaj - gjithsejtë shumë prej 448 €, ndërsa nga data 01.01.2019 e deri me datën 28.02.2023 t'ia kompensojë shumë prej 16 euro në muaj, përkatësisht shumë e tërësishme prej 800 euro, pra gjithsej periudha 1+2 rezulton të jetë 1,248.00 euro. IV. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet administrative të anuluar dhe ka karakter detyrues.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim ndër të tjera thekson, se për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të organit të paditur i referohet nenit 8 paragraf 1 të Ligjit 04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti si dhe në nenin 5 paragraf 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesëve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, duke konstatuar se vendimi me të cilin i refuzohet ankesa paditësit i kontestuar në procedurë gjyqësore nuk është vendim i drejtë dhe ligjor, e po ashtu i nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të LPPA i njëjti nuk është i qartë në dispozitiv dhe arsyetim të mangët në drejtim të përmbledhjes së konstatimeve faktike në bazë të provave të siguruara dhe deklarim të bazës ligjore në të cilat bazohet. Tutje vlerëson se nga provat në shkresa të lëndës vëretohet se paditsi ka kryer shkollimin e mesëm dhe se ka bashkangjitur dokumente relevante si “Diplomën e kryerjes së arsimit të mesëm me numër prot. 271/72. Nr. rendor i librit amëz 1106, i dt. 28.06.1973 ku ceket se kreu arsimimin e mesëm , vërtetimi dega e komunikacionit pran Shkollës së Mesme në Z., andaj i plotëson kushtet sipas nenit 5 par. 2, të U.A. 09/2015 të cilin e citon. Në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurë ankimore duke vepruar sipas ankesës së paditësit, me aktgjykimin AA.nr.366/2023 të datës 14.02.2024, ka vendosur si në vijim: Në pikën I. Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i

Pensioneve, në P., Pika II. Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3030/19, i datës 09.03.2023. Pika III. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A.C., nga P., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, në P., me nr. të dosjes 203033 të datës 01.11.2019. Pika IV. Mbetet në fuqi vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, në P., me nr. të Dosjes, të datës 01.11.2019, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e z/znj. A.C., me numër të ID, për Njohjen e të Drejtës në Kategorizim për Pension me Shkollim të Mesëm.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj, gjykata e shkallës së dytë thekson se: duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes vlerëson se aktgjykimi i goditur, është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së. Andaj, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ti përkrah si të rregullta dhe të ligjshme, sepse argumentet në të cilat bazohet për fakte vendimtare gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, nuk janë bazuar në gjendjen e fakteve të administruara në baza ligjore si në vendimin e kontestuar. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar provat relevante, ndryshe, andaj ekzistojnë kundërthënie në mes asaj që në arsye të aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumenteve, e që si pasojë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale. Duke shqyrtuar vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Pensioneve në P., me nr. të dosjes 203033 të datës 01.11.2019 dhe aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, kjo gjykatë gjen se vendimi i të paditurës MPMS-DP është i plotë në përmbajtjen e tij, dhe është i bazuar në prova dhe argumente nga palët ndërgjyqëse, nga të cilat vërtetohet në mënyrë të plotë gjendja faktike e çështjes. Ndërsa, aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të lartcekura, kjo për faktin se vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në P., nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Tutje theksohet se: nga përmbajtja e vendimit të të paditurës dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton që paditësi nuk ka përmbushur kushtet dhe kriteret në kuptim të nenit 5 par.5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues për arsye se kualifikimi shkollor nuk është në harmoni me kornizën ligjore me vetë faktin që përgatitja shkollorë-vërtetimi nr.1043 dt.26.04.2016 i vërtetuar te Noteri nuk mund të merret si bazë për vendimmarrje nga se është në kundërshtim me pikën 5 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues. Sepse nga ky dokument shihet se paditësi me afatin e gushtit të viti shkollor 1972/73 nga dt.28.01.1973 deri me dt.06.09.1973 ka kryer degën e komunikacionit-voztës. Andaj nga kjo rezulton se paditësi nuk e ka të kryer shkollën e mesme sepse një mundësi e tillë nuk ka ekzistuar që në një afat prej 7 (muajve) të kryhet arsimimi i mesëm. Ndërsa Diploma e personit tjetër Sh.A., nuk mund të merret si provë relevante. Andaj, në bazë të këtyre fakteve, pretendimet e paditësit se ka paraqitur prova të mjaftueshme lidhur me të drejtën në kategorinë e pensionit kontributpagues me përgatitje të shkollës së mesme, sipas dokumenteve të paraqitura nuk janë të bazuara, ngase siç u theksua më lartë vërtetimi nr.143 i vërtetuar te Noteri nuk mund të merret si bazë për vendimmarrje meqë është në kundërshtim me nenin 5 par.5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, Gjykata Supreme pas vlerësimit të aktgjykimit të kundërshtuar dhe shqyrtimit të pretendimeve nga kërkesa, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë dhe në baza ligjore me aprovimin si të bazuar të ankesës së të paditurës MPMS-Departamentit i Pensioneve dhe ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi

i kontestuar përmbanë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sipas nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MPMS, nr.09/2015, për kategorizimin e shfrytëzueseve të pensionit kontribut pagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve - stazhit pensional, është përcaktuar kualifikimi i shfrytëzueseve të pensionit kontribut pagues, ndërsa sipas paragraf 2, të këtij neni përcaktohet, citim, *“Shfrytëzuesi i pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer shkollimin e mesëm”*. Ndërsa në kuptim të nenit 6 paragraf 1 të këtij udhëzimi, është përcaktuar se: *“Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontribut pagues, përkatësisht të siguruarit me rastin e parshtrimit të kërkesës për pension kontributpagues, bazuar në kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, duhet të sjellin dëshmitë relevante, të përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, varësisht se për cilën kategori aplikojnë”*.

Bazuar në dispozitat e cituara si më lartë të cilat rregullojnë juridikisht çështjen e ngritur nga paditësi në organin administrativ si dhe në procedurë gjyqësore, sipas dëshmive në dosje të lëndës të paraqitura nga pala paditëse përkatësisht nga Vërtetimi me nr.protokolli 277/72 të datës 26.04.2016, të lëshuar nga Arkivi Ndërkomunal i Mitrovicës - Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në të cilën e bazon të drejtën e pretenduar për përfundimin e shkollës së mesme, provohet se i njëjti është kualifikuar për profesionin e vozitësit - dega komunikacion pranë shkollës së Nxënësve në Ekonomi – Z,. Nga ky fakt provohet se, paditësi nuk i plotëson kushtet për tu kategorizuar në grupin e dytë me përgatitje të mesme shkollore, kjo ngase sipas këtij vërtetimi A. C., këtu paditësi, kalon provimin përfundimtar, citim, *“në afatin e gushtit të vitit shkollor 1972-93 nga data 28.01.1973 deri më 06.09.1973 kreu dega komunikacion - vozitës, pranë Fondi: Shkollës së Nxënësve në Ekonomi - Z”*,.

Kolegji i Gjykatës Supreme njëjtë si gjykata e shkallës së dytë vlerëson se, nga dëshmitë e paraqitura nga paditësi nuk provohet se i njëjti i plotëson kushtet për tu kategorizuar në kategorinë e II-të, sipas strukturës kualifikuese, me shkollim të mesëm ashtu si parashihet me nenin 5.2, të U.A. 09/2015, për kategorizimin e shfrytëzueseve të pensionit kontribut pagues sipas strukturës kualifikuese sepse nga Vërtetimi i paraqitur nuk dëshmohej se është lëshuar nga një Institucion Arsimor i Mesëm Shkollor, por është lëshuar nga Shkolla e Nxënësve në Ekonomi - Zveçan, pra me këtë vërtetim dëshmohej se paditësi ka kryer shkollimin për vozitës, e cila as nga emërtimi, përmbajtja e vërtetimit por as nga kohëzgjatja e përfundimit të saj nuk mund të merret si shkollë ekuivalente me shkollimin e mesëm.

Nga gjendja e vërtetuar në procedurë ankimore sipas ankesës së paditësit me të drejtë gjykata e shkallës së dytë, duke u bazuar në provat e administruara, ka vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se e paditura MPMS-Departamenti i Administratës Pensionale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike me refuzimin e ankesës së paditësit si të pa bazuar si në vendimin e tij të kontestuar me ankesë, sepse ky organ duke vendosur në ri procedurë në zbatim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, A.nr.8/17, të datës 07.08.2019, me të cilin lënda i ishte kthyer në rishqyrtim, ka vërtetuar faktet që paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për njohjen e të drejtës në kategorizimin në grupin e dytë me përgatitje të mesme shkollore, sepse i njëjti posedon një vërtetim për kualifikimin në degën e komunikacionit si vozitës, por jo përgatitjen e mesme shkollore, për të realizuar të drejtën në pension të plotë të kategorisë së dytë me përgatitje të mesme shkollore, në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Skemat Pensionale të financuara nga shteti dhe aktet nënligjore të cekura si më lartë.

Gjykata Supreme duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, dhe shqyrtimit të pretendimeve të paditësit si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, i cili pretendon se e paditura dhe gjykata e shkallës së dytë, vendimet e tyre

gabimisht i kanë mbështetur në nenin 5 paragraf 5, të Udhëzimit Administrativ MPMS, Nr.09/2015, ku përcaktohet se: *“Të gjitha dëshmitë për kualifikim të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991”*, vlerëson se pretendimi i tillë lidhur me zbatimin e kësaj dispozite nuk ka ndonjë ndikim në ndryshimin e gjendjes faktike. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi as para organit administrativ dhe as para gjykatës nuk ka ofruar dëshmi - diplomën relevante për përfundimin e shkollimit të mesëm dhe në këtë kontekst nuk mund të shqyrtohet nëse diploma është e para apo pas datës 01.01.1991 me që nuk e ofron si provë. Në rastin konkret fillimisht duhet të plotësohet kushti për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara sipas ligjit, respektivisht diplomës mbi bazën e të cilës dëshmohet se paditësi ka përfunduar me sukses shkollimin e mesëm dhe pastaj të shqyrtohet periudha e përfundimit, dhe përputhshmëria me dispozitat ligjore materiale të Ligjit nr. 04/L-131, për Skemat pensionale të financuara nga shteti dhe aktet nën ligjore që e rregullojnë kategorizimin e përfitueseve të pensionit kontribut pagues të moshës.

Gjykata Supreme ka shqyrtuar pretendimin e paditësit, ku thekson se, bazuar në nenin 16 paragraf 2 të Ligjit për Arsimin e Mesëm nr.21/1967 (Fl. Zyrtare e RSS-së, nr.21/67), i njihet shkolla e mesme për punëtor të kualifikuar, dhe duke e ndërlidhur me këtë me vërtetimin të cilin e paraqet në emër të tij nr. 1043 dt.26.04.2016, të cilin e llogarit ekuivalent me diplomën me numër të protokollit 271/72 dhe numër rendor të librit të amzës 1106, në emër të personit tjetër Sh.A., kolegji i kësaj gjykate këtë pretendim pasi që e shqyrtuan në baza ligjore e vlerëson të pa bazuar sepse Diploma e cila figuron në emër të personit Sh.A, është lëshuar nga Shkolla për Punëtorë të Kualifikuar, M - Z dhe e njëjta nuk mund të merret si provë relevante, se e paditura në raste të ngjashme ka vepruar ndryshe ashtu si e thekson paditësi, ngase një gjendje e tillë nuk mund të provohet vetëm me paraqitjen e diplomës në emër të personit tjetër, por me fakte dhe prova tjera relevante personale për deri sa vërtetimi të cilin e paraqet si provë, të vërtetuar tek Noteri, nga ky vërtetim provohet se i njëjti ka kryer shkollën për punëtor të kualifikuar, dega e komunikacion-vozitës brenda periudhës prej shtatë muaj,(prej 28.01.1973 deri 06.09.1973) andaj nuk mund të pranohet si dëshmi për vendimarrje ndryshe, për tu pranuar se ka kryer shkollën e mesme, ashtu si parashihet me nenin 5 par. 5 të U.A.nr.09/2015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesëve të Pensionit Kontributpagues.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, vlerësoj se këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 52 paragraf 1, të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ.nr. 41/2024, datë 30 Prill 2024,

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani